



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

---

Numri i lëndës: 2019:077823

Datë: 01.03.2021

Numri i dokumentit: 01887662

**C.nr.408/18**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**, si gjykatë civile e shkallës së parë, me gjyqtarin Venhar Salihu, në çështjen juridike të paditësit S. V. nga fsh. Kravaricë, Komuna e Gjilanit, të cilën me autorizim e përfaqëson Vehbi Ismajli avokat nga Prishtina, kundër të paditurit Kompania e Sigurimeve "Prisig", me seli në Prishtinë, me objekt kontesti kompenzimi i dëmit, pas seancës kryesore dhe publike të dt. 18.02.2021, jashtë seance, me datë 01.03.2021, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. APROVOHET pjesërisht** si e bazuar kërkesëpadia e paditësit S. V. e paraqitur kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "Prisig", me seli në Prishtinë dhe **DETYROHET** e paditura, që paditëses ti paguajë, shumat si në vijim:

- a). shumën prej 1,500.00 € në emër të dhimbjeve fizike;
- b). shumën prej 1,500.00€, në emër të frikës;
- c). shumën prej 210 € për ndihmë dhe kujdes të personit tjetër ;
- d). shumën prej 210 € për ushqim të përforcuar si dhe
- e). shumën prej 49 €, në emër të shpenzimeve materiale për mjekim, të gjitha këto në shumë të përgjithshme prej 3,469.00 €, të gjitha këto me kamatë ligjore në lartësi prej 8%, duke llogaritur nga data 18.02.2018 si datë kur është shkaktuar dëmi dhe deri në pagesën përfundimtare, në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjyqimit, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

**II. REFUZOHET** si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit S. V., përtej shumës së gjykuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi, përkatësisht shumat prej 1,900.00 €, të kërkuara në emër të dhimbjeve fizike dhe frikës, shumën prej 340 €, për përkuqjesje dhe ndihmë të personit të tretë dhe shumën prej 260 €, në emër të ushqimit të përforcuar si dhe shumën prej 330 € për 15 ditë të qëndrimit në bajë.

**III. DETYROHET** Kompania e Sigurimeve "Prisig", me seli në Prishtinë që paditëses S. V., ti paguaj shpenzimet e procedurës në shumë të përgjithshme prej 912.60 €, të gjitha këto, në

afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm<sup>1</sup>.

## **A r s y e t i m i**

Paditësja pranë kësaj gjykate ka paraqitur padi kundër të paditurës për kompensimin e dëmit, duke theksuar se me datë 18.02.2018, rreth orës 18:05 minuta në lagjen e Myhyrëve në Bresalc, rruga magjistrale Gjilan – Prishtinë ka ndodhur aksidenti i komunikacionit ku paditësja ka pësuar lëndime të rënda trupore dhe më pas ka kërkuar ndihmë pranë Spitalit të Përgjithshëm në Gjilan. Me së nuk ka mundur të realizoj me procedurë administrative të drejtën e saj, paditësja ka paraqitur këtë padi dhe nga gjykata ka kërkuar që të aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e saj dhe të detyrohet e paditura që ti paguaj shumën e përgjithshme prej 10.984€<sup>2</sup>, për lëndime trupore, përjetimin e frikës, dëmin material dhe shpenzimet e procedurës.

I autorizuari i paditëses në seancën përgatitore, kryesore dhe në shpjegimet përfundimtare ka mbetur në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë duke theksuar se pas administrimit të të gjitha provave është vërtetuar teza e kërkesëpadisë e për këtë arsye ka kërkuar që të detyrohet e paditura që paditëses ti paguaj shumën prej 2,450.00 € në emër të dhimbjeve fizike, shumën prej 2,450.00€, në emër të frikës, shumën prej 555 € për përkujdesje dhe ndihmë të huaj, shumën prej 470 € për ushqim të përforcuar si dhe shumën prej 49 €, në emër të shpenzimeve për shërim, pra në shumë të përgjithshme 6,304.00 € të gjitha këto me kamatë ligjore në lartësi prej 8%. Gjithashtu i njëjti ka kërkuar shpenzimet e procedurës 984.60 €.

E paditura në seancën përgatitore, kryesore dhe në shpjegimet përfundimtare ka deklaruar se nuk e ka kontestuar bazën juridike të kërkesëpadisë por lartësinë e shumave të kërkuara, gjithashtu kanë pretenduar se rastin konkret paditësja nuk e ka pasur rrypinë e sigurisë të vendosur dhe këtë veprim, ka kontribuar në lartësi prej 30% për dëmin të cilin i është shkaktuar. Nga gjykata ka kërkuar që të vendos në bazë të provave, pasi që shumat e kërkuara me lëndimet e lehta të pësuar janë jashtë standardit dhe praktikës gjyqësore, kurse sa i përket ndihmë nga personi i 3-të gjykohen nga 5 deri 10 € në ditë, kurse sa i përket shërimit klimatik në mungesë të provave kanë kërkuar që të refuzohet ky shpenzim. Për shpenzimet e procedurës kanë propozuar që me rastin e vendosjes të kenë parasysh suksesin e arritur.

### **Provat e administruara**

Gjykata për të vërtetuar gjendjen faktike dhe për të vepruar drejtë në lidhje me këtë çështje civile-kontestimore dhe duke u bazuar në nenin 8 të LPK- së, ka administruar dhe vlerësuar këto prova: dy foto me ngjyra dhe janë nxjerrë ekspertizat mjeksore nga lëmitë e psikiatrisë, ortopedisë dhe stomatologjisë.

Dr. Abdylatif Latifi ortoped në konstatimin e tij mjekësore, ka vërtetuar se paditësja në aksidentin e dt. 18.02.2018, ka pasur lëndime trupore të natyrës së lehtë. Dhembje fizike

<sup>1</sup> Në emër të taksës për padi ka kërkuar shumën prej 102 €, por shumën prej 30 € për taksë.

<sup>2</sup> Në shqyrtimin e datës 18.02.2021 i autorizuari i paditëses ka bërë zvogëlimin e kërkesëpadisë.

të intensitetit posaçërisht të lartë ka pasur 30 min., kurse dhembjet me intensitet të lartë kanë zgjatur 20 ditë, dhembje të intensitetit të mesëm 35 ditë dhe intensitet të ulët ka pasur 6 javë pas aksidentit. E njëjta nuk ka pasur shëmtim në aspektin estetik e gjithashtu zvogëlim të aktivitetit jetësor nga ky aksident nuk ka pasur. Sa i përket ndihmës dhe ushqimit të përforcuar paditësja ka pasur nevojë për 3 javë.

Dr. Shkelzen Kadriu neuropsikiatër në konstatimin e tij mjekësor, ka vërtetuar se paditësja nga aksidenti, përkatësisht pas aksidentit në komunikacion në vendin e ngjarjes ka përjetuar frikë si pasojë e gjendjes traumatike aksidentale dhe frikë primare të intensitetit të lartë 3 ditë, frikë të intensitetit të mesëm 2 javë dhe frikë të intensitetit të lehtë 1 muaj.

Dr. Alban Shabani stomatolog në konstatimin e tij pas leximit, shiqimit dhe ekzaminimit të drejtpërdrejtë të paditëses ka ardhë në përfundim se e njëjta nuk ka pasur dhëmbë të thyer në aksidentin e dt.18.02.2018 këtë duke u bazuar në rëntgenin e datës 19.02.2018.

Konstatimeve të ekspertit të lartcekur, gjykata ia fali besimin e plotë, pasi që i njëjti ekspert ka një përvojë të gjatë në këtë lëmi, konstatimi i tij ishte punuar në mënyrë profesionale dhe duke përdorur metodat e parapara për vlerësimin e dëmit.

### **Gjendja faktike**

Për palët ndërgjyqëse nuk ka qenë kontestuese baza ligjore e padisë, nuk ka qenë kontestuese se me dt.18.02.2018, është shkaktuar aksident trafiku, ku paditësja nga ky aksident ka pasur lëndime dhe për këto lëndime është paraqitur në Spitalin e Përgjithshëm në Gjilan dhe ka pasur kontrolla të vazhdueshme edhe pas ditës së aksidentit<sup>3</sup>, por për palët ndërgjyqëse ka qenë kontestuese lartësia e kërkesë padisë dhe lëndimet e marra në këtë aksident<sup>4</sup>.

Sa i përket faktit kontestues gjykata, përkatësisht gjyqtari i çështjes pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqësve dhe provave të nxjerra në kuptim të nenit 8 të LPK- së, me kujdes dhe ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit pjesërisht është e bazuar dhe ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Se paditësja në aksidentin e dt. 18.02.2018 ka pasur lëndime të lehta trupore dhembje fizike të intensitetit posaçërisht të lartë ka pasur 30 min., kurse dhembjet me intensitet të lartë kanë zgjatur 20 ditë, dhembje të intensitetit të mesëm 35 ditë dhe intensitet të ulët ka pasur 6 javë pas aksidentit. E njëjta nuk ka pasur shëmtim në aspektin estetik e gjithashtu zvogëlim të aktivitetit jetësor nga ky aksident nuk ka pasur. Sa i përket ndihmës dhe ushqimit të përforcuar gjykata ka vërtetuar se paditësja ka pasur nevojë për 3 javë (fakte këto të vërtetuara nga ekspertiza mjekësore ortopedike). Gjithashtu paditësja nga aksidenti, përkatësisht pas aksidentit në komunikacion në vendin e ngjarjes ka përjetuar frikë si pasojë e gjendjes traumatike aksidentale dhe frikë primare të intensitetit të lartë edhe atë 3 ditë, frikë të intensitetit të mesëm 2 javë dhe frikë të intensitetit të lehtë 1 muaj (fakte këto të vërtetuara nga ekspertiza mjekësore neuropsikiatrike). Kurse nga ekspertiza stomatologjike gjykata ka vërtetuar se nga aksidenti në fjalë e njëjta nuk ka pasur asnjë dhëmbë të thyer.

<sup>3 3</sup> Kjo është konstatuar edhe në procesverbalin e datës 08.07.2019 (f.3, pasuesi 4).

<sup>4</sup> I autorizuari i paditëses ka pretenduar se paditësja ka pësuar lëndime të rënda, kurse i autorizuari i të paditurës lëndime të lehta.

## **Vendimi i gjykatës**

Gjykata vendosi si në pikën I të këtij aktgjykimi që ta aprovoj pjesërisht kërkesë padinë e paditësit, duke u bazuar në nenet 136.1, 137, të Ligjit të Marrëdhënieve të Detyrimeve si dhe nenit 9 dhe 10 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto përgjegjësia, edhe atë pasi që vërtetoi se paditësja ka pësuar lëndime të lehta trupore, ka pasur dhembje fizike dhe ka përjetuar frikë siç është vërtetuar edhe sqaruar në gjendjen faktike dhe për këto arsye gjykoi që e paditura paditësit t'i paguaj shumat prej nga 1500€ për dhimbje fizike dhe në emër të fikës, kurse sai përket shumës prej 210 € për ndihmë të personit tjetër dhe shumën prej 210 € për ushqim të përforcuar, pasi që vërtetoi me ekspertizën mjekësore se paditësja ka pasur nevojë për tri javë për përkujdesje nga personi tjetër dhe tri javë për ushqim të përforcuar, ku 21 ditë ka llogaritur nga 10 € në ditë dhe me matematikë të thjeshtë na del shuma prej 210 € ( $21 \times 10 = 210$ ). Gjykata ka vlerësuar se shumat e aprovuara janë shuma reale dhe sado pak do ti shpërblehet dëmi jo material për shkak të këtij aksidenti, sa i përket lartësisë gjykata u bazua në nenin 323 të LPK-së. Sa i përket shumës prej 49 €, në emër të dëmit material, kjo shumë u aprovua, pasi që e paditura nuk e kundërshtoi shumën e lartcekur në emër të dëmit material.

Sa i përket kamatës, gjykata u bazua në nenin 382.2 të LMD-së, kurse sa i përket llogaritjes së kamatës u vendos bazuar në nenin 170 të LMD-së, edhe atë nga dita e aksidentit, si datë kur është shkaktuar dëmi.

Gjykata vendosi si në pikën II të diapozitivit të këtij aktgjykimi, që të refuzoj vlerën e kërkuar përtej shumës së gjykuar (aprovuar) edhe atë shumën prej 1,900 €, të kërkuara në emër të dhimbjeve fizike dhe frikës, shumën prej 340 €, për përkujdesje dhe ndihmë të personit të tretë dhe shumën prej 260 €, në emër të ushqimit të përforcuar, pasi që në rastin konkret shumat e aprovuara si në pikën I për dëmin jo material për shkak dhimbjeve fizike dhe frikës janë shuma reale dhe janë satisfaksion moral për paditësen, kurse sa i përket ndihmës të personit të tretë dhe ushqim të përforcuar, gjykata refuzoi pasi që shumat e aprovuara nga 10 € në ditë janë reale dhe janë në përputhje me standardet e jetës tonë.

Sa i përket shumës prej 330 € për 15 ditë qëndrimit në bajë gjykata e refuzoj këtë shumë, duke u bazuar në nenin 322, pika 1 dhe 2 të LPK-së, pasi që paditësja me asnjë provë të vetme nuk ka vërtetuar se e njëjta ka qëndruar në bajë ose ndonjë qëndër të rehabilitimit.

Gjykata vendosi si në pikën III të diapozitivit të këtij aktgjykimi, duke u bazuar në nenin 452 të LPK-së, pasi që e paditura ka humbur këtë rast dhe për këtë arsye e detyroi të njëjtën që paditësit ti paguaj shpenzimet e kësaj procedure edhe atë: shumën prej 104€ për përpilimin e padisë, shumën prej 270.40 €, për dy seanca të mbajtura, shumën prej 41 € për taksën për padi si dhe shumën prej 302 €, për shpenzimet e ekspertizave mjekësore.

Sa i përket provave të tjera materiale, gjykata nuk i ka administruar, për shkak se e paditura nuk i ka kundërshtuar faktet të cilat vërtetohen me ato prova.

Prandaj, gjykata nga të lartcekurat, dhe bazuar në nenin 2 lidhur me nenet 142 pika 1 dhe 2 të LPK-ës, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Numri i lëndës: 2019:077823  
Datë: 01.03.2021  
Numri i dokumentit: 01887662

**Gjyqtari,**  
Venhar SALIHU

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë Gjykatës se Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të të njëjtit, përmes kësaj gjykate.